

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Pëdríbuka procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit **K. S. L.** nga fshati **L.** Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.1342-1/2017 të datës 14.08.2017, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, në prezencën e prokurorit të shtetit Musli Gashi, të akuzuarit dhe mbrojtësit Avokat Q. K. nga Prizreni, me datë 04.10.2017 publikisht mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

K. S. L. nga i ati **B.** dhe e ëma **Xh.** e lindur **E.**, i lindur më datë **...** në fshatin **L.** Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, bukëpjekës – tani në pension, i martuar, baba i pesë fëmijëve; me numër personal **...**, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 02.05.2017 rreth orës 09:35 minuta, në Prizren Lagjen A. rrugën “...”, gjatë vozitjes së automjetit të markës “VW Passat” me targa të regjistrimit **...** me numër të shasisë **WVWZZZ3BZXP209063**, viti i prodhimit 1998, i akuzuari nënshtrohet kontrollit rutinor nga ana e zyrtarëve të policisë, ndalohet me qëllim të kontrollit dhe pas verifikimit të dokumentacionit dhe të dhënave në automjet, është vërejtur se automjeti në fjalë nuk ishte i doganuar dhe i regjistruar në territorin e Republikës së Kosovës dhe targat të cilat ishin vendosur në të i përkisnin një automjeti tjetër, ashtu që i akuzuari me dijeni të plotë e përdor dokumentin e falsifikuar si origjinale në qarkullim publik.


Këso dore ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPK.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 43, 46, 73 dhe nenit 398 par.2 lidhur me par.1 të KPK, të akuzuarit i shqipton dënimin dhe atë:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 300 € (treqind euro), i cili dënim duhet të paguhet në gjashtë këste nga 50 € (pesëdhjetë euro) në muaj dhe atë në fillim të muajit prej 01 – 08 të muajit vijues, pas marrjes së aktgjykimit. Nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në afatin ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

Të akuzuarit i shqiptohet dënimi plotësues marrja e sendit, në pajtim me nenin 62 par.1 nën par.2.7 të KPK i konfiskohen targat e regjistrimit me numër 04-993-AC, si mjet i kryerjes së veprës penale.



Obligohet i akuzuari të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1342-1/2017 të datës 14.08.2017, ndaj të akuzuarit I L nga fshati L Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPK.

Me datë 14.08.2017 prokurori i shtetit ka parashtruar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, hartuar nga ana e prokurorit të shtetit në pajtim me të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij Avokat Q K nga Prizreni.

Në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë e hartuar nga ana e prokurorit të shtetit me pëlqimin e akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, kanë përcaktuar kushtet e pranimit të fajësisë, ku në mes tjerash është negociuar dhe propozuar dënimi për të akuzuarin. Në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë në dispozitivin nën III. është rekomanduar dënimi me gjobë ndaj të akuzuarit Islam Laçaj, për veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPK dhe është propozuar dënimi me gjobë në lartësi prej 300 € (treqind euro).

Prokurori i shtetit deklaron pas konsultimit dhe sipas autorizimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë në Prizren, në prani të akuzuarit I L dhe mbrojtësit të tij avokat Q K, kanë lidhur marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Palët në procedurë paraprakisht janë njoftuar edhe me propozimin sa i përket dënimit. I akuzuari dhe mbrojtësi janë pajtuar me kushtet e marrëveshjes ashtu që vullnetarisht kanë lidhur të marrëveshje e cila është nënshkruar nga ana e prokurorit të çështjes, të akuzuarit dhe mbrojtësi të tij, kjo marrëveshje është nënshkruar edhe nga ana e Kryeprokurorit të Prokurorisë në Prizren. Andaj nga gjykata kërkon që marrëveshje të aprovohet.

Mbrojtësi i akuzuarit I L – Avokati Q K deklaroj se mbrojtja pas konsultimeve të mjaftueshme me të akuzuarin dhe pas njoftimit të njëjtit lidhur me favorët dhe pasojat me rastin e arritjes së marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, qëndrojnë në tërësi dhe atë në të gjitha pikat e marrëveshjes. Gjatë seancës mbrojtja ka bërë propozim gjykatës që dënimin e rekomanduar në lartësi prej 300 €, ta mundësoj të akuzuarit që ta paguaj me këste, pasi që i njëjti është i gjendjes së varfër ekonomike. Po ashtu propozoi gjykatës që marrëveshja e arritur të aprovohet nga ana e gjykatës.

I akuzuari në tërësi pajtohet me theksimet e mbrojtësit të tij dhe nga gjykata kërkon që të mundësoj që dënimin me gjobë të paguaj në këste, pasi që është i gjendjes së dobët ekonomike, për shkak të shëndetit të dobët merr pension nga kategoria e personave me aftësi të kufizuar në shumë prej 75 €.

Gjykata gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka vërtetuar këtë gjendje faktike. Ditën kritike me datë 02.05.2017 rreth orës 09:35 minuta, i akuzuari Islam

Laçaj si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor ka drejtuar automjetin e markës "VW Passat" me targa të regjistrimit , me numër të shasisë WVWZZZ3BZXP209063. Më pas në rrugën " " është nënshtruar kontrollit rutinor dhe pas verifikimit të dokumentacionit dhe të dhënave në automjet, është vërejtur se automjeti në fjalë nuk ishte i doganuar dhe i regjistruar në territorin e Republikës së Kosovës dhe targat të cilat ishin vendosur në të i përkisnin një automjeti tjetër. I akuzuari i vetëdijshëm për veprimet e veta me dijeni të plotë e përdor dokumentin e falsifikuar si origjinale në qarkullim publik. Këtë gjendje faktike gjykata ka vërtetuar nga përmbajtja dhe kushtet e pranimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, ku i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet.


Gjykata, sipas detyrës zyrtare në harmoni me nenin 257 të KPPK, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme e cila është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore e cila do të vente në dyshim dhe do të bënte të papranueshëm pranimin e fajësisë – marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Gjithashtu, gjykata konsideroi se nuk ekzistojnë rrethanat të përcaktuara nga neni 253 të KPPK, të cilat do të konsistonin në krijimin e situatës dhe rrethanave për hedhjen e aktakuzës.

Gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranim të fajësisë, gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, për veprën penale e cila i vihet në barrë, me ç'rast nga ana e akuzuarit në mënyrë vullnetare është pranuar fajësia, pa kushtëzime, pa presione dhe askush nuk ka bërë premtim të kundërligjshëm i cili do ti shtyj në pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, por e gjithë kjo është bërë pas konsultës së mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe në harmoni me dispozitat e neneve 233 dhe 246 e 248 të KPPK. Gjykata gjithashtu nga i akuzuari ka vërtetuar se marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë e ka pranuar pa asnjë presion me vullnet të plotë dhe heq dorë nga e drejta në gjykim të rregullt, respektivisht nga të gjitha të drejtat që kanë të bëjnë me gjykimin e rregullt. Sa i përket vendimit mbi dënimin prokurori i shtetit i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, propozuan gjykatës që të aprovoj dënimin e përcaktuar në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata duke marruar në konsideratë rrethanat të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, respektivisht rrethanat e përcaktuara me nenin 73 të KPK, erdhi në përfundim se dënimi i rekomanduar nga palët është dënim i cili i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit. Gjatë vendosjes mbi dënimin, gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethana lehtësuese konsideroi: pranimin e fajësisë nga ana e akuzuarit, ku këtë gatishmëri të pranimit të fajësisë i njëjti ka shprehur që në fazat e hershme të procedurës dhe atë me lidhjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Andaj, bazuar në rrethanat e lartë – theksuara gjykata ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në tërësi me të gjitha pikat e saja, me ç'rast të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin e rekomanduar, ashtu që i shqiptoj dënimin me gjobë, i bindur se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, që i akuzuari në të ardhmen të jetë më i përgjegjshëm dhe të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Vendimi mbi dënimin plotësues është marrë në pajtim me nenin 62 par.1 nën par.2.7 të Kodit Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e mori në kuptim të nenit 453 të KPPK.



Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1610/2017 të datës 04.10.2017

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka



UDHËZIM JURIDIK: Ky aktgjykim është i plotfuqishëm që nga dita e shpalljes – publikimit me datë **04.10.2017**, pasi që palët kanë hequr dorë nga e drejta e ushtrimit të ankesës.